



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 22.01.2024

Drejtoria e Administratës

Shërbimi për Kuvend dhe Komitete

Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës

Prej: Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Ali Ismaili

**Lënda: Raporti i Punës për punën dhe funksionimin e Kuvendit të Komunës së Fushë
Kosovës për periudhën janar/dhjetor 2023**

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës përmes kësaj informate paraqet punën e vetë për periudhën janar/dhjetor të vitit 2023, e cila është e bazuar në dispozitat dhe detyrimet që dalin për Legjislativin e Komunës, si organi më i lartë i komunës nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjet Sektoriale, Udhëzimet Administrative, Statuti i Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012 dhe Rregullorja për Punën e Kuvendit të Komunës Nr. 62, të datës 16.05.2013, për realizimin e punëve dhe detyrat e punës së Legjislativit të Komunës.

Kuvendi i Komunës, mbështetur në kompetencat dhe përgjegjësitë e tij, ka mbajtur gjithsej njëmbëdhjetë mbledhje të rregullta, dy të jashtëzakonshme dhe një mbledhje solemne. Mbeshtetur në propozimet e paraqitura për shqyrtim nga Ekzekutivi i Komunës dhe plani i punës së Kuvendit, pas shqyrtimit të propozimeve në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa, Komitetit për Komunitete dhe në fund në Kuvendin e Komunës, është miratuar 'Planin Vjetor për Punën e Kuvendit të Komunës për vitin 2023', 'Rregullorja për Shërbime Publike Komunale, Rregullorja për organizimin e punës në institucionet arsimore dhe Rregullorja për varreza, shërbimet e varrimit dhe mirëmbajtjen e tyre', ndërsa në muajin dhjetor 2023 është miratuar edhe Rregullorja për 'Transparencë' dhe vendimet e marra nga Kuvendi i Komunës, që do të jenë të përshkruara në listën e vendimeve në formën tabelare, po ashtu për mbledhjet e mbajtura janë përgatitur ekstraktet e procesverbaleve, të cilat janë publikuar në ueb-faqën e komunës pas aprovimit të tyre.

Arsyeja kryesore për kthyerjen në rishqyrtim të disa vendimeve, kryesisht nga MMPHI, MFT dhe MBPZHR janë synimet dhe programi i Ekzekutivit të Komunës, për zhvillimin ekonomik lokal dhe vendimeve me karakter strategjikë, urbanistikë dhe zhvillimor, të cilat kërkohet të vendosen në harmoni me Hartën Zonale të Komunës.

Në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, për të gjitha pikat e rendit të ditës që janë shqyrtuar ka pasur debate të hapura dhe përmbajtjesore para marrjes së vendimeve. Vendimet e marra nga Kuvendi i Komunës dhe të konfirmuara nga Ministritë e linjës janë të publikuara në ueb-faqe. Lidhur me pyetjet e parashtruara nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, janë dhënë përgjigje gojore për një pjesë të tyre nga Drejtorët e Drejtorive të Komunës dhe Nënkryetari i Komunës. Sfida të Kuvendit mbeten, publikimi i audioincizimeve që duhet të realizohet nga Ekzekutivi i Komunës. Po ashtu i kemi të miratuara në parim nga Kuvendi i Komunës, edhe tetë rregullore dhe një plan të veprimet. Strukturën e këtij ‘Raporti të punës së Kuvendit të Komunës për periudhën janar/dhjetor 2023, e paraqesim në formën tabelare për secilin vendim, vendimet e rishqyrtuara dhe aktet e përgjithshme të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës’.

Pjesë përbërëse e ‘Raportit për punën dhe funksionimin e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën janar/dhjetor 2023’, është lista e rregulloreve, planeve, vendimeve, vendimeve të shfuqizuara dhe vendimeve të kthyera në rishqyrtim nga Ministritë e linjës, të cilat edhe pas rishqyrtimit kanë mbetur në fuqi, meqë nuk janë ndryshuar dhe nuk janë shfuqizuar.

Në muajin nëntor është lëshuar mbledhja e Kuvendit të Komunës, nga përfaqësuesit e subjektit politikë Lëvizja Vetëvendosje, për arsye të mos hyrjes për shqyrtim në rendin e ditës të ‘Propozimit për faljen e tatimit në pronë për vitin 2023’, ndërsa në muajin dhjetor është lëshuar mbledhja e Kuvendit të Komunës, nga përfaqësuesit e Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lëvizjes Vetëvendosje, me arsyetimin se nuk janë lejuar të jepen përgjigje nga Drejtorët e Drejtorateve të Komunës, nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, meqë sipas sqarimit të tij është kaluar minutazha e planifikuar me Planin Vjetor të Punës, për pikën pyetje dhe përgjigje parlamentare, andaj përgjigjet e Ekzekutivit të Komunës, do të jepen në mbledhjen e ardhshme.

Përshkrimi i rrjedhës së vendimeve dhe zbatimi i tyre.

Numri i vendimeve të marra për periudhën janar/dhjetor të vitit 2023 në Kuvendin e Komunës është gjithsej 65.

- Numri i vendimeve dhe vendimeve të ndryshuara pas rishqyrtimit dhe në zbatim është 45.
- Numri i vendimeve të rishqyrtuara dhe ndryshuara është 4.
- Numri i vendimeve të shfuqizuara është 6.
- Numri i vendimeve të mbetura në fuqi pas rishqyrtimit është 4.
- Është marrë edhe një vendim për të kërkuar lejimin e zhbllokimit të mjeteve financiare nga të hyrat vetjake të komunës të pashpenzuara.
- Për tre vendime të Drejtorisë së Arsimit nuk kemi përgjigje nga Ministria e Arsimit dhe Ministria e Financave.
- Nga muaji dhjetor 2023, dy vendime i kemi në procedurë të rishqyrtimit në Ministritë e linjës.
- Janë miratuar katër rregullore dhe gjashtë plane, prej tyre një rregullore dhe një plan janë në procedurë të rishqyrtimit

Me respekt!

Tabela 1 Mbledhjet e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës dhe komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera të Kuvendit për periudhën janar/dhjetor 2023

Emri i Komunës	Mbledhje rregullta	Mbl. Jashtëzakonshme	Mbl. urgjente	Mb. solemne
KUVENDI	11	2		1
K.POL.FINANCA	11			
K.KOMUNITETI	11			
K.AKRS	5			
K.SHMS	1			
K.BMU	2			
K.PUKISHP	1			
K.PNV	1			

Tabela 2 - Planet dhe Rregulloret e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën janar-dhjetor 2023

1.	Plani Vjetor i Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023.	24 06.02.2023	Është e konfirmuar ligjshmëria e planit dhe zbatimi i tij.
2.	Rregullorja për Organizimin e Punës në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta dhe Shkollat e Mesme të Larta në Komunën e Fushë-Kosovës.	26 06.02.2023	Është e konfirmuar ligjshmëria e Rregullores dhe zbatimi i saj.
3.	Rregullorja për Shërbime Publike në Komunën e Fushë-Kosovës.	28 06.02.2023	Është e konfirmuar ligjshmëria e Rregullores dhe zbatimi i saj.
4.	Rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	30 06.02.2023	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij
5.	Plani për Barazi Gjinore i Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën trevjeçare 2023-2025.	67 06.03.2023	Është e konfirmuar ligjshmëria e planit dhe zbatimi i tij

6.	Plani Komunal për menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027 në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	134 07.06.2023	Është e konfirmuar ligjshmëria e planit dhe zbatimi i tij
7.	Plani Komunal për Rintegrimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2023-2025.	136 07.06.2023	Është e konfirmuar ligjshmëria e planit dhe zbatimi i tij
8.	Plani Lokal i Veprimit për Cilësi të Ajrit në Komunën e Fushë-Kosovës.	163 08.09.2023	Është e konfirmuar ligjshmëria e planit dhe zbatimi i tij
9.	Plani Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës.	226 29.12.2023	Është në procedurën e shqyrtimit në Agjensinë për Barazi Gjinore
10.	Rregullore për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës.	228 29.12.2023	Është në procedurën e shqyrtimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal

Tabela 3 - Vendimet e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën janar-dhjetor 2023

Nr.	Nr. Prot/dt	Emërtimi i vendimit të Kuvendit	Rishqyrtimi i vendimit
1.	14 03.02.2023	Për rritjen e të hyrave vetanake për vitin 2022 në buxhetin e Komunës së Fushë-Kosovës, në shumën e mjeteve financiare prej: 842,934.00€.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
2.	15 03.02.2023	Për lejimin e bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 4ates4 2022, në vitin 4ates4 2023 në shumë të përgjithshme prej 6,354,114.03€, sipas propozimit dhe përshkrimit në dokumentin financiar të Drejtorisë së Financave dhe Buxhetit me Nr. 48, të 4ates 18.01.2023.	Sqarim: Vendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga të hyrat vetjake të komunës është ndryshuar në mbledhjen e dt 31.05.2023, 22.06.2023 dhe në fund me 26.07.2023.
3.	23 06.02.2023	Për miratimin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.

4.	25 06.02.2023	Për miratimin e Rregullores për Organizimin e Punës në Shkollat Fillore të Mesme të Ulëta dhe Shkollat e Mesme të Larta në Komunën e Fushë-Kosovës.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
5.	27 06.02.2023	Për miratimin e Rregullores për Shërbime Publike në Komunën e Fushë-Kosovës.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
6.	29 06.02.2023	Për miratimin e Rregullores për varreza, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
7.	31 06.02.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
8.	32 06.02.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
9.	35 06.02.2023	Për rishqyrtimin dhe ndryshimin-plotësimin e 5ates një të vendimit Nr. 285, të 5ates 29.12.2022, për lejin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës, me dokumentacion personal të identifikimit, për periudhën janar-mars 2023, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve 20, programi 18162, me mundësi vazhdimi edhe për tre muaj, në shumën e mjeteve financiare prej: 245.00€, nga buxheti i komunës për çdo 5ates5ur të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.	Vendim i rishqyrtuar me ndryshimet e kërkuara për ndërrim të kategorisë ekonomike të shpenzimeve nga kapitalet tek subvencionet.
10.	33 06.02.2023	Për lejin e mjeteve financiare në shumë të përgjithshme prej 50,000.00€, nga 'Kodi i bashkëfinancimit' me numër 44684, programi 17502, ndihmë për Komunitatet e Republikës së Kosovës të dëmtuara nga vërshimet e muajit janar 2023 si vijon: Për Komunën e Skënderajit, lejohet shuma e mjeteve financiare prej: 20,000.00€; Për Komunën e Mitrovicës së Jugut, lejohet shuma e mjeteve	Vendim i rishqyrtuar i mbetur në fuqi, pa asnjë ndryshim në strukturën e tij.

		financiare prej: 10,000.00€; Për Komunën e Istogut, lejohet shuma e mjeteve financiare prej: 10,000.00€ dhe Për Komunën e Klinës, lejohet shuma e mjeteve financiare prej: 10,000.00€.	
11.	34 06.02.2023	Për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 24,900.00€, nga 'Kodi i bashkëfinancimit' me numër 44684, programi 17502, për Kompaninë Rajonale të Mbeturinave 'Pastrimi', njësia Fushë-Kosovë, për mbulimin e pagesave ndaj kreditorit KMDK. Sh.a, mbështetur në vendimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të KRM 'Pastrimi' me Nr. 74, të 6ates 11.01.2023.	Vendim i rishqyrtuar i mbetur në fuqi, pa asnjë ndryshim në strukturën e tij.
12.	67 06.03.2023	Për miratimin e Planit për Barazi Gjinore të Komunës së Fushë-Kosovës për periudhën trevjeçare 2023-2025.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
13.	65 06.03.2023	Për aprovimin e Propozimit Nr. 165, të datës 15.02.2023, për fillimin e konsultimeve në kuadër të Nismës për realizimin e Bashkëpunimit ndërkomunal me Komunitat e Regjionit të Prishtinës si vijon: Komunën e Prishtinës; Komunën e Fushë-Kosovës; Komunën e Obiliqit; Komunën e Lipjanit; Komunën e Podujevës dhe Komunën e Graçanicës.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
14.	64 06.03.2023	Lejohet shpenzimi i mjeteve financiare në shumë prej: 265,000.00€, nga kodi i projektit të 'Bashkëfinancimi i projekteve', për ndihmë ekonomike familjare dhe realizimin e projekteve për zhvillimin e bujqësisë në vitin 2023 si vijon: shumë prej: 30,000.00€ për blerjen e 'Serrave'; shumë prej: 50,000.00€ për blerjen e 'Motokultivatorëve'; shumë prej: 138,000.00€ për blerjen e 'Mekanizmit bujqësor'; shumë prej: 15,000.00€ për blerjen e 'Pajisjeve bletare'; shumë prej: 15,000.00€ për blerjen e 'Folive'; në shumë prej: 17,000.00€ për blerjen e 'Plehut Azotik'.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij,

15.	69 06.03.2023	Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për Njësinë e Zjarrfikësve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, në fshatin Bardh i Vogël në këto ngastra kadastrale si vijon: Ngastra Kadastrale me Nr. P-72514049-00053-0, në sipërfaqe prej: S=110m ² , në vendin e quajtur 'Kod Dubova Qar', e evidentuar në certifikatën e pronës së datës 14.02.2023, në Zonën Kadastrale Bardh i Vogël; Ngastra Kadastrale me Nr. P-72514049-00054-0, në sipërfaqe prej: S=693m ² , në vendin e quajtur 'Kod Dubova Ara Fushë', e evidentuar në certifikatën e pronës së datës 14.02.2023, në Zonën Kadastrale Bardh i Vogël; Ngastra Kadastrale me Nr. P-72514049-00055-0, në sipërfaqe prej: S=2503m ² , në vendin e quajtur 'Kod Dubova Bataline', e evidentuar në certifikatën e pronës së datës 14.02.2023, në Zonën Kadastrale Bardh i Vogël.	Vendimi është kthyer në rishqyrtim dhe është shfuqizuar.
16.	66 06.03.2023	Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-Kodit të Etikës në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si vijon: Fisnik Sllamniku, Laureat Gojnovci, Doruntina Jashari, Migjen Kolshi, Hasan Ismajli, Vlora Kurtaj, Miranda Sulejmani, Ganimete Berisha, Ali Topalli, Veselin Petrovic dhe Maliq Thaçi.	Sqarim: Vendimet për Grupe Punues dhe Komisione të punës nuk shqyrtohen, ato mund të zbatohen pas aprovimit të tyre.
17.	68 06.03.2023	Për shfuqizimin e vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 284, të datës 29.12.2022, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-4/5, të datës 09.02.2023, lidhur me Propozimin Nr. 1255, të datës 13.12.2022 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për dhënien në shfrytëzim me qira të objekteve të Ambulancave të Mjekësisë Familjare për periudhën njëvjeçare në fshatrat si vijon: Objekti shëndetësorë në Henc i ndërtuar në Ngastrën Kadastrale me Nr. P-72514031-00383-0; Objekti shëndetësorë në Bardh i Vogël i ndërtuar në Ngastrën Kadastrale me Nr. P-72514049-00197-0 dhe Objekti shëndetësorë në Graboc i Poshtëm i ndërtuar	Shfuqizimi i vendimit sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-4/5, të datës 09.02.2023, lidhur me Propozimin Nr. 1255, të datës 13.12.2022 të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për dhënien në shfrytëzim me qira të objekteve të Ambulancave të Mjekësisë Familjare.

		në Ngastrën Kadastrale me Nr. P-72514028-00855-0.	
18.	85 06.04.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
19.	86 06.04.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Transportin Rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
20.	87 06.04.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Orarin e punës së veprimtarive ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
21.	88 06.04.2023	Për ndryshim – plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.6, të vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa për të realizuar ndërrimin e përfaqësueses së Lëvizjes Vetëvendosje si vijon: Për largimin e znj. Eglantina Azemi nga përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa prej shtatë anëtarëve dhe Për caktimin e znj. Hasime Kostanica në cilësinë e anëtares së re të Komitetit për Politikë dhe Financa.	Vendimi për ndërrimin e anëtarëve është i zbatueshëm pas verifikimit të tij sipas afatit ligjor.
22.	89 06.04.2023	Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2, të vendimit Nr. 52, të datës 07.03.2022 për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për të realizuar ndërrimin e përfaqësueses së Lëvizjes Vetëvendosje si vijon: Për largimin e znj. Hasime Kostanica nga përbërja e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale prej pesë anëtarëve dhe Për caktimin e znj. Doruntina Jashari në cilësinë e anëtares së re të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.	Vendimi për ndërrimin e anëtarëve është i zbatueshëm pas verifikimit të tij sipas afatit ligjor.
23.	91 06.04.2023	Për shfuqizimin e vendimit Nr. 69, të datës 06.03.2022, sipas shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-245/3, të datës 17.03.2023 dhe shkresës së	Është shfuqizuar vendimi sipas kërkesës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor

		Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës me Nr.1237-2/23, të datës 17.03.2023, lidhur me aprovimin e Propozimit Nr. 138, të datës 15.02.2023, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për Njësinë e Zjarrfikësve, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	dhe Infrastrukturës me Nr.1237-2/23, të datës 17.03.2023 dhe shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-245/3, të datës 17.03.2023.
24.	90 06.04.2023	Për lejimin e mjeteve financiare për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për banorët e Komunës së Fushë-Kosovës, me dokumentacion personal të identifikimit, për periudhën prill – dhjetor 2023, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve 20, programi 18162, në shumën e mjeteve financiare prej: 245.00€, nga buxheti i komunës për çdo 9ates9ur të varrimit, përfshirë të gjitha komunitetet fetare.	Vendimi është i zbatueshëm, si vazhdim i mbulimit të shpenzimeve të varrimit prill-dhjetor 2023 nga kategoria e subvencioneve.
25.	92 06.04.2023	Për formimin e ‘Grupit punues për hartimin e Projekt-Rregullores për Taksa Komunale në Komunën e Fushë-Kosovës, në përbërje prej njëzet e një anëtarëve si vijon: Laureat Gojnovci, Etnik Berjani, Doruntina Jashari, Migjen Kolshi, Bashkim Krasniqi, Idriz Idrizi, Ekrem Gojnovci, Merita Krasniqi, Besim Tërmmkollli, Blerta Begolli Musolli, Adelina Gashi, Ardit Sekiraqa, Nexhat Bajçinca, Ganimete Berisha, Miranda Sulejmani, Fatlum Berisha, Sulejman Shabani, Besa Budakova, Besare Sllamniku Aliu, Zoran Kitic dhe Avdyl Krasniqi.	Sqarim: Vendimet për Grupe Punues dhe Komisione të punës nuk shqyrtohen, ato mund të zbatohen pas aprovimit të tyre.
26.	116 05.05.2023	Për miratimin e Rregullores Komunale për bonuse të zonimit në Komunën e Fushë-Kosovës.	Kjo rregullore pas rishqyrtimit të saj në Kuvendin e Komunës ka mbetur në fuqi, meqë nuk ka patur pjesëmarrje të mjaftueshme në procesin e votimit.
27.	114 05.05.2023	Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për rekrutimi e Drejtorit të Institucionit Parashkollorë në Fushë-Kosovë: Elmie Grajçevci Zymberi – Kryetare e Komisionit, përfaqësuese e Drejtorisë Komunale të Arsimit; Esat Simnica - anëtar i Komisionit, drejtor në Shollën Filllore të Mesme të Ulët	Sqarim: Vendimet për Grupe Punues dhe Komisione të punës nuk shqyrtohen, ato mund të zbatohen pas aprovimit të tyre.

		‘Selman Riza’ në Fushë-Kosovë; Përfaqësuesi nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit, anëtar i Komisionit; Një anëtar nga Këshilli i Prindërve në cilësinë e vëzhguesit dhe Një anëtar nga Këshilli i Institucionit Parashkollorë në cilësinë e vëzhguesit.	
28.	112 05.05.2023	Për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitet 2023-2027, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Vendimi është rishqyrtuar dhe përmirësuar sipas shkresës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës me Nr. 2552-3/23, të datës 24.05.2023, në bazën e tij ligjore.
29.	110 05.05.2023	Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027.	Vendimi është shfuqizuar sipas shkresës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. sipas shkresës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. Nr. 2551-3/23, të datës 24.05.2023, lidhur me aprovimin e Propozimit Nr. 258, të datës 17.03.2023.
30.	115 05.05.2023	Për shfuqizimin e vendimit Nr. 287 të datës 30.12.2022 dhe rregullores Nr. 289 të datës 30.12.2022 për bonuse të zonimit, shkresën me Nr. 40-2/23, të datës 25.01.2023, të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës dhe shkresën Nr. 0-910/6, të datës 25.01.2023, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe shkresës tjetër me Nr. 954/23, të datës 28.03.2023, të dorëzuar tek Drejtoria e Planifikimit Urban, nga Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.	Vendimi është shfuqizuar sipas shkresës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. 40-2/23, të datës 25.01.2023 dhe shkresën Nr. 0-910/6, të datës 25.01.2023, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe

			shkresës tjetër me Nr. 954/23, të datës 28.03.2023, të dorëzuar tek Drejtoria e Planifikimit Urban, nga Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës.
31.	128 31.05.2023	Për shpalljen e shkrimtarit dhe publicistit z. Ismail Kadare “Qytetar nderi” i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2023, është i lindur me datën 28.01.1936, në qytetin e Gjirokastrës, shkollën fillore dhe të mesme e kreu në vendlindje Degën e Gjuhës dhe Letërsisë, në Universitetin e Tiranës në vitin 1958 dhe studimet për Letërsinë Botërore “Maksim Gorki”, në Moskë 1958-1960, është shkrimtar i letërsisë shqipe dhe një ndër shkrimtarët e njohur të letërsisë botërore, autor i shumë veprave letrare, shumë këngëve, publicist i njohur i adresimit të çështjeve me rëndësi shoqërore dhe kombëtare të popullit tonë me ndikim në formimin e brezave.	Vendimi është i zbatueshëm.
32	130 01.06.2023	Për ndryshimin-plotësimin e vendimit Nr. 15, të datës 03.02.2023, për paragrafin një të lejimit të bartjes së mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit fiskal 2022, në vitin fiskal 2023, sipas Rekomandimit Nr. 129, të datës 31.05.2023 nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, që ndërlihet me hapjen e kodit të ri në investime kapitale të emërtimi i projektit për ‘Blerjen e pronës në lagjen 028 dhe 029 në lagjet e banuara nga komunitetet joshumicë në Komunën e Fushë-Kosovës’, e prezantuar edhe në formën tabelare - pjesë e vendimit Nr. 15, të datës 03.02.2023, fshihet tërësisht nga paragrafi një i vendimit dhe pjesa tabelare e vendimit për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar për vitin 2022.	Vendimi është i zbatueshëm.
33.	132 07.06.2023	Për shfuqizimin e vendimit Nr. 110, të datës 05.05.2023 dhe Planit Lokal të Veprimit Nr. 111, të datës 05.05.2023, për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit në	Vendimi është shfuqizuar-sipas shkresës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit

		territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027, sipas shkresës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës me Nr. 2551-3/23, të datës 24.05.2023, lidhur me aprovimin e Propozimit Nr. 258, të datës 17.03.2023, për shqyrtimin e dytë të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit për marrjen e vendimit për miratimin e këtij plani.	Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. Nr. 2551-3/23, të datës 24.05.2023, lidhur me aprovimin e Propozimit Nr. 258, të datës 17.03.2023.
34.	133 07.06.2023	Për rishqyrtimin dhe përmirësimin e vendimit Nr. 112, të datës 05.05.2023, për miratimin e Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027 dhe Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave Nr. 113, të datës 05.05.2023, sipas shkresës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës me Nr. 2552-3/23, të datës 24.05.2023, në bazën e tij ligjore.	Vendimi është përmirësuar sipas shkresës së Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës me Nr. 2552-3/23, të datës 24.05.2023, në bazën e tij ligjore.
35.	135 07.06.2023	Me aprovimin e këtij vendimi Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, bazuar në Strategjinë për Migrim 2021-2025, të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr. 22/2020 për rintegrimimin e personave të riatdhesuar, Rregulloren për integrimin e të huajve Nr. 09/2019, miratohet 'Plani Komunal për Rintegrimimin e Qëndrueshëm të Personave të Riatdhesuar dhe Integrimin e të huajve në Komunën e Fushë-Kosovës për vitet 2023-2025'.	Vendimi është i zbatueshëm.
36.	131 07.06.2023	Për zhbllokimin e mjeteve financiare të grumbulluara nga të hyrat vetanake të Komunës së Fushë-Kosovës në vitet 2021 dhe 2022, për shpenzim në vitin 2023, nga niveli qendror - Qeveria e Republikës së Kosovës, respektivisht Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve, sipas specifikimit të mjeteve financiare të vitit 2021 dhe 2022, në Propozimin e Kryetarit të Komunës me Nr. 556, të datës 18.05.2023, është si në vijim: Shuma e përgjithshme e mjeteve financiare të	Sqarim: Vendimi i Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës lidhur me kërkesën për zhbllokimin e buxhetit të bartuar nga vitet paraprake drejtuar Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve.

		grumbulluara nga të hyrat vetanake për vitet 2021 dhe 2022 është prej: 6,354,114.03€, prej këtyre mjeteve financiare të kontraktuara për shpenzime nga vitet e kaluara në vitin 2023, është shuma prej: 1.625.537.98€, e shpërndarë dhe zbërthyer në vitet përkatëse; Shuma e ndarë e mjeteve financiare për vitin 2021, është në shumë prej: 3,287,802.98€, ndërsa prej këtyre mjeteve financiare të kontraktuara për shpenzime, është shuma prej: 923,517.28€; Shuma e ndarë e mjeteve financiare për vitin 2022, është në shumë prej: 3,066,311.05€, ndërsa prej këtyre mjeteve financiare të kontraktuara për shpenzime, është shuma prej: 702,020.70€.	
37.	137 07.06.2023	Për aprovimin e Propozimit Nr. 172, të datës 19.05.2023, për lejimin e fillimit të procedurave për shndërrimin e zonës bujqësore në zonë ndërtimore, për banim individual në Zonën Kadastrale Miradi e Epërme, për bllokun e evidentuar ZB me Nr. 1228, në bllok ndërtimor për ZB2 - me destinim për banim individual, që parasheh gjatë procedurës në faza edhe ndryshim-plotësimin e Hartës Zonale të Komunës së Fushë-Kosovës.	Sqarim: Vendimi i kthyer në rishqyrtim, ka mbetur në fuqi pas rishqyrtimit të tij në mbledhjen e dt 31.08.2023.
38.	144 23.06.2023	Për bartjen e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2022, sipas kërkesës së Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve të datës 12.06.2023 dhe dokumentacionit financiarë, nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit - shih: tabelën buxhetore prej dy faqeve që është pjesë përbërëse e këtij vendimi. Shpërndarja e mjeteve financiare të bartura sipas përshkrimit bazik në pikën një të vendimit dhe tabela buxhetore, është pjesë e vendimit për shpërndarjen e buxhetit nga të hyrat vetanake dhe ndërlidhet me vendimet tjera të Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës, me Nr. 15, të datës 03.02.2023 dhe vendimit me Nr. 130, të datës 01.06.2023. për ndryshim-plotësim.	Vendimi është rishqyrtuar sipas shkresave të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve për ndarjen e buxhetit të bartur dhe të pashpenzuar nga të hyrat vetjake të vitit 2022, tani është në procedurë të realizimit të tij.

39.	147 27.06.2023	Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale 2024-2026, me kufijtë e caktuar buxhetor si vijon: Për vitin 2024 buxheti i komunës është në shumë prej: 16,285,500.00€; Për vitin 2025 buxheti i komunës është në shumë prej: 17,098,096.95€; Për vitin 2026 buxheti i komunës është në shumë prej: 17,938,765.00€.	Vendimi është i zbatueshëm, ka hapur procedurën për përgatitjen e buxhetit për vitin 2024 dhe mbajtjen e dëgjimeve buxhetore.
40.	148 04.07.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 për Komunën e Fushë-Kosovës, mbështetur në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave.	Vendimi është i zbatueshëm.
41.	151 26.07.2023	Për bartjen e mjeteve financiare të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2021 për shpenzim në vitin 2023, sipas dokumentacionit financiarë nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit - shih: tabelën buxhetore prej dy faqeve që është pjesë përbërëse e këtij vendimi.	Vendimi është i zbatueshëm.
42.	162 08.09.2023	Për miratimin e Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit, në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës për vitet 2023-2027.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
43.	160 08.09.2023	Për aprovimin e Propozimit Nr. 858, të datës 22.08.2023, për lejimin e mjeteve financiare në shumën e përgjithshme prej: 169,344.00€ nga buxheti i komunës, për rritjen e njëzet e katër (24) normave të reja, për mësimdhënës në vitin shkollorë 2023-2024.	Sqarim: Nuk kemi përgjigje nga Ministria e Arsimit dhe MFPT
44.	161 08.09.2023	Për formimin e Grupit Punuese për hartimin e Projekt-Rregulloreve Komunale për subvencione, në përbërje prej gjithsej pesëmbëdhjetë anëtarë, nga Kuvendi i Komunës: Remzi Shala, Krenar Dumani, Durim Hajra, Migjen Kolshi, Arbnore Kelmendi, Hasan Ismajli, Bashkim Krasniqi,	Sqarim: Vendimet për Grupe Punues dhe Komisione të punës nuk shqyrtohen, ato mund të zbatohen pas aprovimit të tyre.

		Artan Asllani, Radoman Doderovic, ndërsa prej Ekzekutivit të Komunës: Besnik Osmani, Mimoza Kolshi, Mehmet Gërguri, Besnik Shala, Fatlum Berisha dhe nga Shoqëria Civile Xhevdet Qiriqi.	
45.	172 29.09.2023	Për aprovimin e Buxhetit të Planifikuar të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024, në shumë të përgjithshme prej 16,285,500.00€, i shpërndarë nëpër programe e nën-programeve të kategorive ekonomike si vijon:	Vendimi është i zbatueshëm.
46.	173 02.10.2023	Për lejimin e vizitës zyrtare në Republikën e Shqipërisë në muajin tetor 2023, e lidhur me ftesën e Bashkisë së Lezhës - Këshillit Bashkiak të Lezhës, sipas shkresës zyrtare me Nr. 14675, të datës 19.09.2023.	Vendimi është i zbatueshëm.
47.	189 07.11.2023	Për aprovimin e Propozimit Nr. 1060, të datës 19.10.2023, për sigurimin e qëndrueshmërisë funksionale të Qendrës së Karrierës, si pjesë përbërëse e IAAP në kuadër të Shkollës së Mesme Teknike 'Minatori' në Fushë-Kosovë.	Sqarim: Nuk kemi përgjigje nga Ministria e Arsimit.
48.	188 07.11.2023	Aprovohet propozimi për hapjen e linjës buxhetore në kategorinë ekonomike 11 për Rroga dhe paga'. Mjetet financiare në shumë të përgjithshme prej 15,176.72€, si të hyra vetjake në arsim, destinohen për pagesat e arsimtarëve dhe stafit arsimor që kanë zhvilluar dhe zhvillojnë procesin mësimorë, mbajtjen e provimeve nga mësimi jo formal dhe alokohen në kategorinë ekonomike 11 në arsimin e mesëm si vijon: në arsim të mesëm për shkollën e Mesme Profesionale 'Hoxhë Kadri Prishtina', kodi i programit Nr.94232, shuma prej:9,421.48€ dhe në arsimin e mesëm për Shkollën e Mesme Teknike 'Minatori' kodi i programit Nr.94231, shuma prej:5,755.24€	Sqarim: Nuk kemi përgjigje nga Ministria e Arsimit.
49.	190 07.11.2023	Për formimin e Grupit Punues për hartimin e Planit Vjetor për Punën e Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024, në përbërje prej njëmbëdhjetë anëtarëve si	Sqarim: Vendimet për Grupe Punues dhe Komisione të punës nuk shqyrtohen, ato mund të

		vijon: Ali Ismaili - Kryesues i Kuvendit të Komunës, kryesues i grupit; Besnik Osmani - Nënkyetar i Komunës, anëtar; Hasan Gjyrevci - Zyrtar i Lartë për Kuvend dhe Komitete, anëtar; Remzi Shala - Përfaqësues i Lidhjes Demokratike të Kosovës, anëtar; Aida Alimi - Përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës, anëtare; Arbnore Kelmendi - Përfaqësuese e Nismës Socialdemokrate, anëtare; Hasan Ismajli - Përfaqësues i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, anëtar; Bashkim Krasniqi - Përfaqësues i Iniciativës së Ashkalive dhe Egjiptianëve për Fushë-Kosovën, anëtar; Artan Asllani - Përfaqësues i Listës Ndryshe, anëtar; Qëndresa Ademi - Përfaqësues i Iniciativës së Ashkalive dhe Egjiptianëve për Fushë-Kosovën, anëtare; Radoman Doderovic - Përfaqësues i Iniciativës së Ashkalive dhe Egjiptianëve për Fushë-Kosovën, anëtare;	zbatohen pas aprovimit të tyre.
50.	201 06.12.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për taksa komunale, për subjektet afariste që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Miratimi në parim i akteve të përgjithshme nuk shqyrtohet nga Ministrinë e linjës
51.	203 06.12.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për orarin e punës, së subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Miratimi në parim i akteve të përgjithshme nuk shqyrtohet nga Ministrinë e linjës
52.	205 06.12.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për transportin rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Miratimi në parim i akteve të përgjithshme nuk shqyrtohet nga Ministrinë e linjës
53	206 06.12.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Miratimi në parim i akteve të përgjithshme nuk shqyrtohet nga Ministrinë e linjës
54.	207 06.12.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores, për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat	Miratimi në parim i akteve të përgjithshme nuk shqyrtohet nga Ministrinë e linjës

		vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	
55.	208 06.12.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Transparencë në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Miratimi në parim i akteve të përgjithshme nuk shqyrtohet nga Ministrinë e linjës
56.	210 06.12.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores, për Standardet minimale të pjesëmarrjes në diskutim publik në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Miratimi në parim i akteve të përgjithshme nuk shqyrtohet nga Ministrinë e linjës
57.	209 06.12.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Planit të Veprimit për Transparencë për vitet 2024-2027 në Komunën e Fushë-Kosovës.	Miratimi në parim i akteve të përgjithshme nuk shqyrtohet nga Ministrinë e linjës
58.	211 06.12.2023	Për miratimin e Propozimit Nr. 371, të datës 30.10.2023, për caktimin e taksës administrative për leje të ndërtimit, leje të rrënitimit dhe tarifës rregullative për rritjen e densitetit në Infrastrukturë në vitin 2024 si vijon: Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 1.50€ për një metër katror në kategorinë e parë; Taksa administrative për lëshimin e lejeve ndërtimore në shumë prej 1.65€ për një metër katror në kategorinë e dytë; Taksa administrative për leje të rrënitimit në shumë prej 0.80€ për një metër katror; Tarifa rregullative për rritjen e densitetit në infrastrukturë në shumë prej 5.72€ për një metër katror. Miratimi i taksave administrative dhe tarifës për rregullimin e densitetit në infrastrukturë për vitin 2024, mbështetet në shkresën e Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me Nr. 5761-2/23, të datës 17.10.2023.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
59.	202 06.12.2023	Për shfuqizimin e vendimit Nr. 86, të datës 06.04.2023, për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për orarin e punës së subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Është shfuqizuar vendimi Nr. 86, të datës 06.04.2023.

60.	204 06.12.2023	Për shfuqizimin e vendimit Nr. 87, të datës 06.04.2023, për aprovimin në parim për diskutim publikë të Projekt-Rregullores për Transportin Rrugor në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.	Është shfuqizuar vendimi Nr. 87, të datës 06.04.2023.
61.	224 29.12.2023	Për aprovimin në parim për diskutim publikë të Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024.	Miratimi në parim i Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2024, nuk shqyrtohet.
62.	227 29.12.2023	Për miratimin e Projekt-Rregullores për Transparencë në Komunën e Fushë-Kosovës.	Është në procedurë të rishqyrtimit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
63.	225 29.12.2023	Për miratimin e Projekt-Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës. Planit Lokal të Veprimit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje për vitet 2024-2026 në Komunën e Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh zbatimin nga institucionet komunale të programeve, punëve dhe aktiviteteve për mbrojtjen nga dhuna në familje.	Është në procedurë të rishqyrtimit në Agjensinë për Barazi Gjinore.
64.	229 29.12.2023	Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.2, të vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke e larguar e z. Remzi Shala nga përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa prej shtatë anëtarëve dhe për caktimin e z. Laureat Gojnovci në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Politikë dhe Financa. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 199, të datës 31.12.2021, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa, në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë si: shqyrtimin e politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik,	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.

		kornizën vjetore afatmesme buxhetore, planin vjetor të prokurimit, rregulloren vjetore për tatimet, tarifat dhe pagesat, planin vjetor të punës për auditimin e brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim gjatë vitit fiskal, si dhe marrjen e raportit nga Kryetari i Komunës dhe dorëzimin e rekomandimeve në Kuvendin e Komunës.	
65.	230 29.12.2023	Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.1, të vendimit Nr. 52, të datës 07.03.2022 për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale për të realizuar ndërrimin e përfaqësuesit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, duke e larguar z. Laureat Gojnovci nga përbërja e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale prej pesë anëtarëve dhe caktimin e z. Fidan Berisha në cilësinë e anëtarit të ri të Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 52, të datës 07.03.2022, për themelimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë e definuara në nenin 8, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.	Është e konfirmuar ligjshmëria e vendimit dhe zbatimi i tij.
	Përshkrimi i rrjedhës së vendimeve dhe zbatimi i tyre.	Numri i vendimeve të marra gjithsej në Kuvendin e Komunës është 65.	Numri i vendimeve dhe vendimeve të ndryshuara pas rishqyrtimit dhe në zbatim është 45. Numri i vendimeve të rishqyrtuara dhe ndryshuara është 4. Numri i vendimeve të shfuqizuara është 6. Numri i vendimeve të mbetura në fuqi pas rishqyrtimit është 4. Është marrë edhe një vendim për të kërkuar lejimin e zhblllokimit të mjeteve financiare nga të

			<p>hyrat vetjake të komunës të pashpenzuara. Për 3 vendime të Drejtorisë së Arsimit nuk kemi përgjigje. Nga muaji dhjetor 2023, 2 vendime i kemi në procedurë të rishqyrtimit.</p>
--	--	--	--